

Organizohet në Universitetin e Elbasanit, takimi i Erasmus+ Mobility Caffé

Universiteti i Elbasanit, organizoi për të dytin vit radhazi takimin Erasmus + Mobility Caffé, me studentë përfitues të programit Erasmus+ dhe Spinaker. Ky takim i kthyer në një traditë në Universitetin e Elbasanit, është një mundësi shume e mirë për studentët, për të shkëmbyer eksperiencat, idetë dhe informacione të dobishme, të cilat i shkruajnë edhe në bllokun e kujtimeve të Erasmus+.

Ky program prej vitesh, mundëson mobilitetin e studentëve në të tre ciklet e studimit në sajë të marrëveshjeve të shumta me universitetet partnere.



